

## SHKALLËT E BESIMTARËVE NË RRUGËTIMIN DREJT ALLAHUT (MEDAARIXH ES-SAALIKIIN)

---

### Vërejtja / *el-Lehdh* / اللَّحْظُ

Dr. Hatim el-Haxh

Materiali është përmbledhje e kuptimeve të audio-ligjëratës nga nxënësit e hoxhës

<https://buff.ly/2hbVv4T>

### Seksioni i Pacenueshmërisë

Për sa i përket seksionit të pacenueshmërisë, kjo ka dhjetë kaptina: vërejtja, saktësia, kthjelltësia, lumturia, privatësia, fryma, tëhuajtja, përthithja, mungimi, vendosja.

Allahu ﷻ tha:

"انظُرْ إِلَى الْجَبَلِ فَإِنِ اسْتَفَرَّ مَكَانَهُ فَسَوْفَ تَرَانِي"

"... Shiko malin. Nëse mbetet në vend, do të më shohësh Mua." (el-A'raf, 143)

*Lehdh* (vërejtja) është një shikim fshehtas i shkurtër<sup>1</sup>. Në këtë kontekst, kjo ka tri nivele:

Niveli i parë është vërejtja e hirit<sup>2</sup> që:

- Ndërpret lutjet për të treguar përlësinë ndaj zotësisë së Tij<sup>3</sup>.

<sup>1</sup> Kjo ka të bëjë me aftësinë e zemrës vështruese për të vjelë shpejtazi dobitë e vështrimit. Meqë objekti përfundimtar i vështrimit është hyjnorja, shikimet e shkurtëra, nga ndjenja e përnderimit, bëhen fshehurazi.

<sup>2</sup> Hiri i Tij i ka paraprirë cilitdo veprimi nga ana jonë. Ai caktoi që njeriut t'i jepen të gjitha mirësitë para krijimit të tij.

<sup>3</sup> Kur personi të kuptojë përparësinë e hirit të Tij, do të jetë i zënë me lavdërimin e Tij dhe nuk do t'i parashtrijë kërkesa Atij; do të kuptojë se kërkesa që bën nuk është shkaku kryesor i mirësive që merr, por shkaku është hiri i Tij paraprijës. Shejhu (el-Harawi), megjithatë, tërheq vëmendjen se duhet vazhduar të lusim Atë për mirësitë e Tij në përgjigje të thirrjes nga ana e Tij për të bërë këtë dhe në shenjë përlësie ndaj Tij. Ibn el-Kajjim shtjellon rëndësinë e lutjes në *Medaarixh*, ku thekson se Allahu e bëri lutjen shkaktar të mirësive të Tij, meqë Ai është Krijuesi i shkakut dhe i pasojës. Ibn el-Kajjim, po ashtu, thotë se të qenët i zënë me lavdërimin e Tij nganjëherë mund të heqë vëmendjen nga lutja për nevojat që kemi, mirëpo kjo është një gjendje

- Kultivon gëzim të përzier me shqetësimin për planet (e Tij)<sup>4</sup>
- Ndjell mirënjohje (nga robi) që është e drejtë e të Vërtetit<sup>5</sup>

Niveli i dytë është të vëresh dritën e zbulimit që:

- Forcon lidhjen<sup>6</sup>
- Lejon shijimin e paraqitjeve<sup>7</sup> (hyjnore)
- Mbron nga gabimi i ngushëllimit<sup>8</sup>

Niveli i tretë është vërejtja e natyrës së bashkimit<sup>9</sup> që:

- Të zgjon nga parëndësia e përpjekjes<sup>10</sup>

---

kalimtare, jo një shkallë (stacion) i përhershëm. Pra, personi duhet të vazhdojë të ndiejë varfërinë dhe nevojën për Allahun dhe ta lusë Atë për të gjitha nevojat e veta. Pejgamberi ﷺ tha:

“Allahu hidhërohet nga ai që nuk e lut.” (et-Tirmidhi nga Ebu Hurejre)

<sup>4</sup> Gëzimi që nuk përzihet me shqetësimin për mundësinë e tërheqjes së të mirave dhe privimin nga të mirat, është një përshpejtues i shkujdesjes dhe i tiranisë. Allahu thotë:

“(Engjëjt do të thonë) Kjo (ndëshkimi) ngaqë gazmoheshit në tokë pa të drejtë dhe silleshit me vrazhdësi.” (Ghaafir, 75)

<sup>5</sup> Askush s’mund t’i shprehë Allahut mirënjohjen e domosdoshme, përveç vetë Atij. Mirënjohja jonë është thjesht një dhuratë nga Ai, gjë që fton për më shumë falënderim.

<sup>6</sup> Miqësia me Allahun dhe të qenët e tënd i lidhur me Të dhe i shkëputur nga çdo gjë tjetër.

<sup>7</sup> Manifestimi i cilësive dhe i veprimeve hyjnore që i bëhet zemrës reflektuese.

<sup>8</sup> Kur personi gjen ngushëllim në jetë larg nga i Dashuri i tij, Zoti.

<sup>9</sup> Bashkimi me hyjnoren.

<sup>10</sup> Kjo mund të nënkuptojë se personi që arrin gjendjen e bashkimit me Allahun, i sheh si të lehta përpjekjet për arritjen e kënaqësisë së Tij. Kjo po ashtu mund të nënkuptojë se mundimet trupore vijnë në rend të dytë pas pajtimit të zemrës me vullnetin dhe caktimin hyjnor. Mënyra si duhet kuptuar këtë është se këta persona njohin rëndësinë e gjendjes së zemrës dhe nuk mbështeten vetëm në përpjekjet trupore. Të këtillët asnjëherë nuk pushojnë së respektuari urdhrat e Zotit të tyre dhe i përmbahen Sunetit të të Dërguarit të Tij, i cili asnjëherë nuk la adhurimin e Zotit të Tij nëpërmjet të brendshmes dhe të jashtmes, derisa i erdhi vdekja, e po kështu edhe shoqëruesit e tij. Allahu tha:

“Adhuro Zotin tënd, derisa të të vijë bindja (vdekja).” (el-Hixhr, 99)

- Ta largon pakujdesinë e mospajtimeve<sup>11</sup>
- Të lë të shohësh fillesat<sup>12</sup>

---

Ibn el-Kajjim përmend në *Medaarixh* shumë thënie të Mjeshtëreve të shtegut të *Tesawufit*, duke theksuar kështu rëndësinë e përputhjes me Sheriat dhe të respektimit të Sunetit nga të gjithë adhuruesit, deri në vdekje.

<sup>11</sup> Personi nuk bën t'i bëjë vërejtje caktimit të Tij krijues ose autoritar. Kjo e fundit trajtohet me dëgjueshmëri, ndërsa e para me pranim (pajtim). Nëse caktimet krijuese dhe autoritare janë në harmoni, si në rastin e atij që agjëron në ramazan dhe ushqen jetimët, akti i këtillë duhet të lavdërohet dhe të mbështetet; nëse nuk janë në harmoni, si në rastin kur personi shtyp të dobët dhe nuk jep zekatin, aktet e këtilla duhet dënuar dhe kundërshtuar, sepse caktimet autoritare janë ato të cilat jemi urdhëruar t'i ndjekim.

<sup>12</sup> Ibn el-Kajjim sugjeron në *Medaarixh* se kjo mund t'i referohet përparësisë së Allahut para të gjitha gjërave ose dhe kohës fillestare kur robi merr shtegun për te Allahu. Kjo është një kohë e përqendrimit dhe e zellit, e cila shpesh u mungon ndjekësve të shtegut gjatë shtegtimit, pavarësisht nga shkalla në të cilën gjenden.